**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**ORTAKU I VETËM I SHOQERISE**
**" VASPORT " Sh.p.k KORÇË**

# VENDIM
**Nr. 5 date 30.11. 2006**

Sot më datën 30.11.2006 në selinë e shoqërisë " VASPORT " Sh.p.k KORÇË, ortaku themelues i shoqërisë;

- Aurel ÇYFEKU , që zotëron 100 % të pjesës së Kapitalit themeltar;

konformë Ligjit Nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare" si dhe rregullave të përcaktuara në Statutin e shoqërisë, mori në shqyrtim sipas rendit të ditës,

a- Miratimin e raportit te Ekspertit per Kontributet Bashkim Gjata te dates 30.11.2006 , lidhur me zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise nepermjet vleresimit te kontributit ne natyre, me perfshirje te fitimeve neto dhe derdhjeve te pronarit ;

për të cilin mbasi u diskutua,

**VENDOSA:**

1- Në mbështetje të neneve 42 dhe 63 të Ligjit si më sipër , të miratoi Raportin e Ekspertit Kontabël të Autorizuar z.. Bashkim Gjata, i caktuar nga ana ime me Vendimin Nr. 4 datë 30.09.2006 , i depozituar ky në Gjykatën e Rregjistrit tregëtar më Vendimin Nr. 31.104 / 1 te dates 21.11.2006 , në cilësinë e Ekspertit të Kontributeve , sipas të cilit është çmuar vlera e kontributit në natyrë të investuar ne shoqeri të vërtetuar me dokument transaksioni financiar , e ndarë sipas zërave tokë e ndertesa dhe mjete transporti .

Vlera e kontributit të investuar gjatë periudhës nga fillimi i aktivitetit deri 30.11.2006, është për shumën **7.350.000** lek . Kjo vlerë e kontributit është përballuar në investim nga vlera e fitimeve neto të realizuara gjatë aktivitetit të shoqërisë , të cilat janë ne bilançin e shoqerise për shumën **5.732.992** lekë .

Në këtë investim , të përfshihet vlera e fitimeve , dhe diferenca prej **1.617.008** lekë , janë derdhje dhe pagesa ne shoqëri të pronarit . Derdhje te pronarit eshte dhe shuma prej **13.296.716** leke qe në bilanç rezulton në Pasiv si borxh i shoqërisë për ortakun , Kredi llogaria 456 , nga e cila ne kontabilitetin e shoqërisë , duhet të pakësohet për diferencën prej **1.617.008** lekë , e përfshirë në kontributin në natyrë të investuar , e cila të kalojë me veprim kontabel në llogarinë 101 , Kapital i nënshkruar .

2- Përfundimisht , zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë të realizohet për shumat;

-Nga kontributi i investuar në shoqëri, të zmadhohet për shumën për shumën **7.300.000** lekë. Diferenca prej **50.000** lekë, mbështetur në nenin 213 të Ligjit Nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare " , të kalojë si rezervë ligjore e shoqërisë.

Kapitali themeltar i nënshkruar bashkë me shumën prej **100.000** lekë, i depozituar me rastin e çeljes së veprimtarisë, ai shkon për vleren **7.400.000** **lekë** , vlerë kjo e gjithë 100 % në pronësi të shoqërisë " VASPORT " Shpk Korçë, sipas raporteve të shprehura në aktet themeluese .

3- Nga dega e finances se shoqerise te behen sitemimet perkatese ne kontabilitetin e shoqerise dhe te depozitohen aktet per zmadhimin e kapitalit ne regjistrin tregetar. Shpenzimet Juridike dhe te Ekspertit te paguhen nga shoqëria .

**ORTAKU I VETËM I SHOQERISE**
**"VASPORT" Sh.p.k. KORÇË**
**( Aurel ÇYFEKU )**

FIRMA SHPK
VASPORT
KORÇE ALBANIA